



---

**Higjiena**

- Ju lutemi të paraqiteni në OP të pastërt (bëni dush duke inkluduar edhe pastrimin e kërthizës), **por të pangjyrosur (pa shminkë) dhe pa krem trupi/Bodylotion.**
- Hiqni dorë bile në njërin gisht nga llakimi i thonjve.

---

**Protezat e dhëmbëve**

- Protezat e plota apo të pjesshme të dhëmbëve gjatë operacionit mund të zhvendosen, të shkaktojnë lëndime, të dëmtohen apo të humbin.
- Për këtë arsye protezat e dhëmbëve para operacionit duhet të hiqen dhe të vendosen në enë speciale të përshkruara me emrin tuaj dhe të lihen në stacion të spitalit.

---

**Ardhja në ditën e operacionit**

- Lajmërohuni në kohën e përcaktuar në sportel „Pranimi i pacientëve“. Këtu Juve do ju tregohet stacioni, se ku juve tani më ju presin dhe do ju tregohet dhoma.

---

**Para operacionit**

- Personeli kujdestarë sigurohet, se a jeni esëll dhe i keni marrë medikamentet e domosdoshme.
- Pas palosjes së rrobave dhe gjëseneve tuaja, ndërroni veshjen.
- Ju do të dërgoheni në OP në momentin kohorë të përcaktuar më parë

---

**Pas operacionit**

- Pas intervenimit ju do të kaloni një kohë në dhomën për zgjim me përkujdesje intensive. Atëherë kur shtypja e gjakut, frekuenca e zemrës- dhe e frymëmarrjes janë stabilizuara dhe dhimbjet ju janë pushuar në mënyrë të mjaftueshme për Ju, atëherë Ju do të dërgoheni prapa në stacion.
- Ju lutemi lajmëroni me kohë nëse Ju ndjeni dhembje apo ndjeni neveri. Një e tillë vlene sikurse për kohën të cilën kaloni në dhomën për zgjim, njashtu edhe më vonë në seksion/ambulatore. Sa më shpejtë që ne e dimë se si ndiheni, aq më shpejtë ne mund të reagojmë.
- Gjatë mobilizimit tuaj fillestar do të ju mbështetet një infermier/e. Ju lutemi, mos dilni vet nga shtratin.

---

**Rregullat e sjelljes pas intervenimeve ambulante**

- Varësisht nga intervenimi është e mundur, që ju mund të shkoni në ditën e njëjtë në shtëpi.
- Intervenimi dhe veprimet e mëtutjeshme të medikamenteve dhe mjeteve anesteziologjike përkohësisht e ulin aftësinë tuaj të gjykitimit dhe reagimit, për këtë arsye Ju duheni veçmas të keni kujdes që:
  - Leni mjetet tuaja motorike në shtëpi, në asnjë mënyrë mos drejtoni automjete.
  - Porositni një person të rritur të ju merr nga stacioni.
  - Gjatë 24 orëve pas lëshimit tuaj, mos bini vendime të rëndësishme dhe veçmas mos nënshkruani akte me plotfuqi ligjore.
  - Mos bini vendime të rëndësishme dhe veçmas mos nënshkruani akte me plotfuqi ligjore.
  - Hiqni dorë përkohësisht nga sporti dhe puna e rëndë fizike.

---

Po që se në shtëpi paraqiten probleme si p.sh. dhembje të forta, neveri, ndjenja të pakëndshme me djersitje dhe zbehje, apo ju keni vërejtur gjakderdhje, atëherë lajmërohuni tek mjeku kujdestar i klinikës (Kirurgji, Kirurgji vaskulare, Ortopedi, Urologji, Gjinekologji; kontaktoni nëpërmes centralit telefonik 056 486 21 11).

**Miratimi dhe vërtetimi**

I/e nënshkruari/ja vërteton, që rregullat e lartë përmendura i ka lexuar dhe kuptuar. Për pasojat të cilat mund të rrjedhin nga mosrespektimi i këtyre rregullave, spitali kantonal Baden AG nuk mund të merr përgjegjësi për ato.

Baden, .....  
(Data)

.....  
(Nënshkrimi Pacientja/Pacienti apo përfaqësuesi ligjorë)